
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data 20/08/2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Blerje pajisje kontenierë për paketimin e shiritit filmik 35 mm te fondit të AQSHF-së”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):

30234700-5 Shirit magnetik
30237370-3 Bobina regjistrimi
32354200-1 Film kinematografik

Vlera e fondit limit: 7,076,333 (Shtatë milion e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mesipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit

tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalohet 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar ” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 42 pika 3, neni 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose

entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. Gjithashtu në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh se vlera e fondit limit për të gjitha lotet është nën kufirin e ulët monetar dhe përcaktimeve të bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcakton se: “Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

2. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin /distributorin e autorizuar nga prodhuesi për artikujt objekt prokurimi. Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Ky kriter është i përcaktuar në Ligj nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në zbatim të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”i ndryshuar, përsa i përket kërkesës për Autorizim për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, garanton furnizime të qendrueshme me gamën e artikujve, të cilët janë tejet specifike për nga natyra dhe kanë nevojë për siguri në zinxhirin e furnizimit.

3.Operatori ekonomik duhet të paraqesë broshurë/skedë teknike/katalog nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi, ku të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit, të përcaktuara në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për

të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe standartet e përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallrat e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të mallrave të ofruara nga operatori ekonomik. Nisur nga lloji i mallit që kërkohet, është e nevojshme që autoriteti kontraktor të sigurohet për mallrat që i ofrohen nga operatorët ekonomik pjesmarrës të vërtetuar nëpërmjet dokumenteve si broshurë/katalogë/skedë teknike nga prodhuesi i mallit. Gjithashtu broshura/katalogë/skedat teknike do të shërbejnë edhe për marrjen në dorëzim të mallit nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

4.Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese çertifikimin ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

5.Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se artikujt objekt prokurimi kanë kaluar me sukses Testin e Aktivitetit Fotografik (Photographic Activity Test – PAT), sipas standartit ISO 18916, ose ekuivalente, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimit, Autoriteti Kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari të dorëzojë dokumentacionin provues që vërteton se materialet e përdorura për prodhimin e artikujve objekt prokurimi kanë kaluar me sukses Testin e Aktivitetit Fotografik (Photographic Activity Test – PAT), sipas ISO 18916:2025, ose standard/metodë ekuivalente, në përputhje me deklarin e paraqitur në ofertë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme (për pikën 4 dhe 5) janë vendosur në përputhje me nenin 79 "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma

ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.” Ky kriter gjen mbështetje gjithashtu në piken 1 të nenit 44 "Kërkesat e cilësisë "të VKM nr.285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se: “1. "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit". ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

Kërkesa për përputhshmërinë e materialeve të përdorura për prodhimin e artikujve objekt prokurimi me ISO 18916:2025 (Photographic Activity Test – PAT), ose standard ekuivalente, lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe destinacionin e tyre. Testi vlerëson ndërveprimet e mundshme kimike ndërmjet materialeve të mbështjelljes dhe materialeve fotografike, duke siguruar përshtatshmërinë e materialit për përdorim në ruajtjen e tyre.

Duke qenë se artikujt objekt prokurimi do të përdoren për ruajtjen dhe mbrojtjen afatgjatë të materialeve filmike/fotografike, është e nevojshme që materiali përbërës i tyre të mos shkaktojë ndërveprime kimike të padëshiruara që mund të dëmtojnë ose përshpejtojnë degradimin e materialeve të ruajtura. Kërkesa për ISO 18916:2025 ose ekuivalent synon të garantojë këtë karakteristikë teknike, pa përcaktuar një markë apo prodhues të caktuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

1. HYRJE

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit (AQSHF) disponon negativët origjinalë 35 mm të prodhuar nga Kinostudio “Shqipëria e re”. Qëllimi i këtij projekti është sigurimi i materialeve të reja të ambalazhimit (konteniere dhe bobina / film cans and cores) për të garantuar ruajtjen afatgjatë të trashëgimisë kulturore dhe mbrojtjen e materialeve të dëmtuara nga koha.

2. QËLLIMI I TERMAVE TË REFERENCËS

Qëllimi i këtyre Termave të Referencës është të përcaktojë kushtet, kërkesat teknike dhe rezultatet e pritshme për furnizimin me materiale specialistike arkivore për paketim / ambalazhim të filmave për ruajtje afatgjatë.

3. OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

Objektivat e Projektit:

- Ruajtja afatgjatë: Të sigurohet mbrojtja dhe konservimi i negativëve të figurës përmes krijimit të kushteve optimale në standarde ndërkombëtare ISO 18902 “Imaging materials — Processed imaging materials — Albums, framing and storage materials” (Materialet e imazhit — Materialet e përpunuara të imazhit — Albume, kornizat dhe materialet e ruajtjes).
- Standardet e larta të cilësisë: Përdorimi i materialeve polipropileni të garantojnë Testin e Aktivitetit Fotografik (PAT) për të garantuar që vetë paketimi nuk do të çlirojë kimikate që dëmtojnë apo zbehin imazhin me kalimin e kohës.
- Forcimi i kapaciteteve: Ngritja e standardeve profesionale në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

4. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË OBJEKTEVE

Bazuar në kërkesat teknike të institucionit, materialet duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:

Nr	Artikulli	Specifikimi Teknik (Materiali)	Përmasat	Sasia
1	Kuti Filmi (Film cans) 35mm	Polipropilen i stabilizuar, ventilim 2×8 mm, Ngjyra: Blu.	380mm x 44mm	5000 copë
2	Bobina (Film cores) 35mm	Polipropilen i stabilizuar (Prime Polypropylene), Ngjyra: Blu	35mm x 75mm	500 copë

5. PËRSHKRIMI I FURNIZIMIT

- Kontenierët (Film Cans): Duhet të jenë të rrumbullakta, me material polipropilen i stabilizuar, të pajisura me hapësira për qarkullimin e ajrit në përputhje me Testin e Aktivitetit Fotografik ISO 18916.
- Bobinat (Film Cores): Duhet të jenë të pajtueshme me formatin 35mm dhe të përshtatshme për montim në makinat e skanimit dhe restaurimit. Bobina duhet të

jetë prej materiali polipropilen i stabilizuar, testuar me sukses për Testin e Aktivitetit Fotografik ISO 18916.

6. STANDARDET DHE UDHËZIMET TEKNIKE

Furnizimi duhet të përmbushë standardet ndërkombëtare për konservimin fizik (physical preservation):

- Materiali duhet të jetë i ri dhe i papërdorur.

7. AFATET DHE PLANI I DORËZIMIT

- Transporti të jetë DAP (Delivered At Place) – në adresën e AQSHF-së Rruga Aleksandër Moisiu, nr 76/1, Tiranë. Operatori Ekonomik merr përsipër të gjitha kostot dhe rreziqet e transportit deri në adresën e Autoritetit Kontraktor.
- Dorëzimi i parë i një sasive kutive dhe bobinave duhet të nisë brenda 4 javëve pas nënshkrimit të kontratës për testim paraprak.
- Dorëzimi final i të gjithë sasisë duhet të përfundojë brenda datës 1.12.2026.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike të përcaktuara për artikujt Kuti Filmi (Film Cans) 35 mm dhe Bobina (Film Cores) 35 mm burojnë nga kërkesat specifike funksionale dhe teknike të procesit të ruajtjes, administrimit dhe trajtimit të materialeve filmike arkivore në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit.

1. Kuti filmi (Film Cans) – Ngjyra blu

Kërkesa që kutitë e filmit të jenë në ngjyrë blu lidhet drejtpërdrejt me sistemin e klasifikimit fizik të fondit arkivor të institucionit (color coding system), i cili përdoret gjerësisht në arkiva për identifikimin e menjëhershëm të kategorive të ndryshmetë materialeve filmike.

Kodimi me ngjyra është pjesë e metodologjisë së administrimit të fondit arkivor dhe shërben për:

- identifikimin vizual të menjëhershëm të zhanreve dhe kategorive të ndryshme të filmave (p.sh. filma artistikë, dokumentarë, filma të animuar etj.);
- uljen e mundësisë së gabimeve gjatë depozitimit, inventarizimit dhe tërheqjes së materialeve nga magazinat arkivore;
- rritjen e efikasitetit operacional gjatë proceseve të konservimit, restaurimit dhe aksesimit të materialeve.

Për rrjedhojë, kërkesa për ngjyrën blu nuk përbën një karakteristikë estetike apo të lidhur me një prodhues të caktuar, por një element funksional që garanton vazhdimësinë e sistemit ekzistues të administrimit të fondit arkivor.

2. Bobina (Film Cores) – Diametri 3 inch

Diametri 3 inch është një kërkesë teknike e domosdoshme për përputhshmërinë me pajisjet profesionale që përdoren aktualisht në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit për trajtimin e materialit filmik.

Të gjitha pajisjet e përdorura për:

- inspektimin e filmit;
- pastrimin;
- riparimin e dëmtimeve mekanike;
- Winding dhe rewinding;
- skanimin dhe proceset e restaurimit;

janë projektuar për përdorimin e bobinave (film cores) me diametër standard 3 inch.

Përdorimi i bobinave me diametër tjetër do të krijonte papajtueshmëri mekanike me pajisjet ekzistuese, duke pamundësuar përdorimin e tyre ose duke kërkuar adaptorë shtesë, të cilët ndikojnë negativisht në stabilitetin e filmit gjatë procesit të punës dhe rrisin rrezikun e dëmtimit të materialit origjinal arkivor.

Për këtë arsye, specifikimi i diametrit 3 inch nuk kufizon konkurrencën, por garanton përputhshmërinë teknike me infrastrukturën ekzistuese dhe zhvillimin e sigurt të proceseve të restaurimit dhe konservimit.

3. Materiali – Polipropilen i stabilizuar (Prime Polypropylene)

Përcaktimi i materialit prej polipropileni të stabilizuar është vendosur për të garantuar përdorimin e materialeve me cilësi arkivore, të cilat karakterizohen nga:

- qëndrueshmëri mekanike afatgjatë;
- rezistencë ndaj deformimeve;
- neutralitet kimik dhe mungesë të emetimeve që mund të ndikojnë negativisht në materialin filmik;
- jetëgjatësi në kushtet e ruajtjes afatgjatë.

Ky material përdoret gjerësisht në industrinë e ruajtjes së materialeve audiovizive dhe ofrohet nga një numër i konsiderueshëm prodhuesish ndërkombëtarë, ndaj nuk identifikon një markë apo prodhues specifik.

4. Ventilimi 2 × 8 mm

Specifikimi për praninë e vrimave të ventilimit me konfigurim 2 × 8 mm është vendosur për të siguruar qarkullimin e kontrolluar të ajrit brenda kutisë së filmit, duke ndihmuar në reduktimin e grumbullimit të lagështisë dhe gazrave që mund të çlirohen nga materiali filmik gjatë ruajtjes afatgjatë.

Hapjet me përmasa më të vogla se 2 x 8 mm reduktojnë ndjeshëm shkëmbimin e ajrit brenda kutisë, duke favorizuar akumulimin e lagështisë dhe të nënprodukteve kimike që çlirohen natyrshëm nga filmi gjatë plakjes (si acidi acetik në rastin e degradimit të bazësacetate), çka mund të përshpejtojë proceset e degradimit. Nga ana tjetër, hapjet me përmasa më të mëdha ose me sipërfaqe totale më të madhe ventilimi rrisin ekspozimin e materialit ndaj pluhurit, grimcave të jashtme dhe luhatjeve të temperaturës e lagështisë relative, duke ulur nivelin e mbrojtjes gjatë ruajtjes dhe transportit. Për

këtë arsye, konfigurimi 2×8 mm përfaqëson një zgjidhje të balancuar, e përdorur gjerësisht në kutitë profesionale për ruajtjen e materialeve filmike, pasi garanton ventilim të mjaftueshëm pa kompromentuar mbrojtjen fizike dhe mikroklimën e brendshme të kutisë.

Keto specifikime teknike janë objektivist të justifikuara nga nevojat funksionale të Autoritetit Kontraktor, garantojnë përputhshmërinë me infrastrukturën dhe pajisjet ekzistuese, si dhe sigurojnë ruajtjen dhe trajtimin e materialeve filmike në përputhje me standardet profesionale të konservimit arkivor.

NJËSIA E PROKURIMIT